



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.01.2019,
duke filluar në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Genc Sherifi, Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rahmani, Fadil Gashi dhe Egzon Azemi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Arđan Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, përfaqësues nga INPO-ja, përfaqësues nga OSCE-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues**, me ketë

REND TË DITËS:

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
2. **Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit";**
3. **Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona";**
4. **Propozimrregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;**
5. **Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës;**

6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë;
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Hortikultura";
8. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë;
9. Diskutim për Raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018;
10. Diskutim për Raportin vjetor të punës së KKSB-së;
11. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstataoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së nëntë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit".

Genc Bashota dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se ka pasur prapë takime me Rektoratin e Universitetit, ku ata prapë shprehin shqetësimin dhe të drejtat rreth kësaj kërkese, se Fakulteti i Shkencave Matematikore i kanë kushtet e këqija, éshtë një prej prioriteteve, se Fakulteti Teknik i ka ndarë mjetet dhe buxhetin e kanë. Ky propozim éshtë i njëjtë me atë të herës së kaluar, nuk ka asnje ndryshim. E juaja éshtë të vendosni si Kuvend se a doni të votoni për apo jo.

Agim Gashi parashtroi pyetjen se sa zgjat procedura deri te e drejta për dhënien e lejes për ndërtim, pasi që janë disa procedura që duhet kaluar.

Genc Bashota tha se ne jem dakorduar, se arkitektë dhe profesionistë nga Universiteti ta hartojnë këtë Plan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit. Nuk mund të jem i saktë, por besoj se për 2 muaj mund të bëhet, sepse éshtë parcelë e madhe.

Egzon Azemi u pajtua me pyetjen që e parashtroi e z. Agim, se sa kohë zgjat, por nëse i shohim gjitha këto plane tjera sa kohë i merr përgjigjja e Ministrisë, pastaj plani, thirrja e diskutimit publike, pas diskutimit shtyhet një deri dy muaj, kështu që nuk ka mundësi teorike që një plan rregullues i hollësishëm të mund të përfundojë para shtatorit të vitit 2019. Andaj,

nëse deri në shtator nuk përfundon, cila është logjika që ne me ngadalësuar veten me dy plane të rëndësishme, që edhe kjo çështje kishte gjetur zgjidhje. Në deklaratën si LV, bashkë me juve si drejtori, ku ka qenë edhe Shpend Ahmeti, tani Kryetar, kemi thënë edhe Harta zonale dhe Plani zhvillimor kanë afat përfundimi 18 muaj, e 18 muaj bëhen në shtator të v. 2019, kështu që nëse e dini se nuk bëhet Harta zonale deri në shtator, atëherë të fillojmë me këtë procedurë së paku për Universitetin, se është çështje e ndjeshme, sepse kërkesa e tyre është me vend, ata i kanë kushtet e vështira. Por, nëse kryhet Harta zonale, nuk ka kurrfarë kuptimi me filluar procedura të panevojshme.

Genc Bashota tha se nuk mund të them se në çfarë date do të kryhet Harta zonale, mirëpo ne asgjë nuk humbim nëse ia japim Universitetit në këtë rast me e zgjidhur problemin e tyre, se atë e bëjnë arkitektët e tyre e ne si staf që jemi duke punuar, nuk jemi asgjë të ngarkuar me të, kështu që aspak nuk e ngadalëson procesin e Hartës zonale.

Egzon Azemi theksoi se çështja e Universitetit është çështje e ndjeshme dhe ne jemi duke dashur ta trajtojmë me argumente, por shpreh dyshim se ky Plani i Universitetit është paraprirje që pastaj të vijnë disa plane të tjera që keni me shfrytëzuar Universitetin si pretekst. Interpretimi ligjor i MMPH-së, i dt. 21.09.2018, neni 6 thotë "Plani rregullues i hollësishëm nuk mund t'i ndryshojë rregullat dhe aktivitetet e zhvillimit hapësinor, të përcaktuara me dokumentet e planifikimit hapësinor që janë fuqi". Ne e dimë se cili plan është në fuqi, PZHU-ja. Çka planifikohet te pjesa e Fakultetit Teknik, ku do të ndërtohet tash fakulteti, me sa e di unë aty ka qenë e planifikuar Salla e operës.

Genc Bashota u përgjigj se i është ndarë një parcelë në shfrytëzim Ministrisë për ndërtimin e Sallës së operës, mirëpo ata nuk kanë aplikuar për leje asnijëherë, do të thotë aty nuk ka plan. **Egzon Azemi** pyeti se a ka ndonjë vendim të ri që e pezullon vendimin paraprak.

Genc Bashota u përgjigj se nuk ka për momentin vendim as që e pezullon, as që e miraton.

Egzon Azemi theksoi se është dashur ne me pasur një vendim që e pezullon Operën dhe fillon me procedura të tjera për Universitetin.

Genc Bashota bëri të ditur se Opera e ka një parcelë në shfrytëzim me ligj, por pas një afati të caktuar nëse nuk e shfrytëzon, atëherë ne kemi të drejt me ia marrë.

Eman Rahmani tha se nuk e di sa i ka përcjellë drejtori prononcimet nga ana e Ministrisë së Kulturës para dy - tri ditëve, ku ka paraqitur një propozim, që aty të ndërtohet Salla e operës, dhe kjo tash bie ndesh me këtë që po e thotë drejtori, mirëpo tjetër është se pse mendojmë se nuk duhet votuar ky plan rregullues, por asnjë plan rregullues, derisa të përfundohet Harta zonale dhe Plani zhvillimor.

Ne po kërkojmë që të përqendrohemë në këto dy projekte shumë të rëndësishme për Prishtinën, e që e zgjidhë edhe këtë problemin e brendshëm këtu ku e keni paraqitur ju, nuk e pengon këtë as hartimi zonal, as plani zhvillimor. Shtoni kapacitetet, filloni punën më me seriozitet, se nuk është bërë asnjë dëgjim publik dhe neve nuk na është paraqitur asnjë punë që është bërë në këtë drejtim. Kjo e ka bllokuar komplet Prishtinën. Nëse duam të punojmë,

atëherë të punojmë për gjithë Prishtinën e jo vetëm për një pjesë, ose po fillojmë e po i bëjmë për secilën lagje planet e hollësishme, e kur të përfundojë hartimi zonal dhe plani zhvillimor, problemin e kemi te selektimi i pjesëve të ndryshme të qytetit.

Halim Halimi tha se raste të tilla kemi pasur qe 5 vjet, d.m.th. edhe Ligji mbi planifikimin hapësinor e dimë se çka shkruan pér nxjerrjen e planeve të hollësishme rregulluese, duhet të jetë Harta zonale, mirëpo Hartën zonale nuk e kemi. Po të ishte Harta zonale ne nuk do të bisedonim fare pér këtë çështje, por jemi ardhur në një situatë të tillë, që harta është dashur të kryhej para 4 - 5 vjetëve, por nuk është bërë. Duke i ditur kushtet në të cilat punon Fakulteti i Shkencave Matematikore, ne do ta kemi parasysh këtë çështje.

Agim Gashi u shpreh se nuk është mirë që sa herë ka nevojë Komuna e Prishtinës pér procedura të tillë, ne të ballafaqohemi me mospajtime të tillë. Në këtë ka një zgjidhje. Kur e kemi interpretuar Udhëzimin administrativ që e ka nxjerrë Ministria dhe që nuk i specifikon në detale këto çështje, por e ka lënë një portë hapur në raste Komuna ka nevojë pér një ndërhyrje të tillë, t'ia drejtojë një shkresë Ministrisë dhe ata ta interpretojë Udhëzimin administrativ e jo të na lejojnë neve ta interpretojmë, sepse po krijojnë konflikt dhe pastaj mos pajtueshmëria në mendime po keqpërdoret pér çështje të interesave politike. Këtu është problemi procedural, por pse shërbimet juridike nuk e rregullojnë këtë çështje, të ulen dhe ta analizojnë, t'i drejtojnë shkresën organit kompetent që e ka nxjerrë aktin nënligjor dhe i cili na shërben pasi ta interpretojë, sepse ai nuk e ka specifikuar, me thënë se derisa të nxirret Harta zonale mund të procedohet me to dhe nuk ka pengesa. Andaj, lus shërbimet juridike që t'i marrin parasysh këto gjëra dhe t'i lehtësojnë procedurat.

Ardian Olluri theksoi se u përmend Harta zonale, çështja që jemi vonuar shumë me Hartë zonale, por nuk jemi vetëm ne që jemi vonuar, janë vonuar të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, lokale dha qendrore, d.m.th. asnjë komunë nuk është para neve në proces, as Ministria nuk ka ecur përpara, që e ka obligim ligjor para komunave në nivel të Kosovës. Nëse është dikush përgjegjës pér këtë dështim planifikimi, nuk është Komuna e Prishtinës, janë ata që e kanë bërë ligjin dhe nuk e kanë menduar se si të zbatohet. Çështja tjeter ishte se a shkakton vonesa. Si e shpjegoi drejtori i Planifikimit, barrën kryesore pér planifikim në këtë rast ka me pasur Fakulteti i Arkitekturës, do me thënë arkitektët e Fakultetit kanë me bërë prezantimin, kjo nuk shkakton vonesa në Hartë zonale, se kanë me u bërë me konkurs të jashtëm. Po ashtu, tha se Egzoni e përmendi Plani zhvillimor urban, tha se është pengesë, jo, PZHU nuk është dokument i planifikimit sipas ligjit të ri.

Egzon Azemi pyeti se cili është ligji në fuqi sipas ligjit të ri.

Ardian Olluri theksoi se Plani zhvillimor komunal dhe dokumentet e planifikimit, duhet mbështetur në këtë dokument të planifikimit si akti më i lartë i planifikimit në nivel komunal.

Egzon Azemi pyeti se a ka mospërputhje Plani zhvillimor komunal.

Ardian Olluri theksoi se, me sa e di unë, nuk ka mospërputhje.

Po ashtu, këtu u përmend Salla e operës dhe baletit, ne jemi duke propozuar dokumente të planifikimit, nuk jemi duke parashikuar se çka do të ketë aty. Ata që e bëjnë planin e vendosin se a do ta lejojnë, apo nuk do ta lejojnë sallën aty.

Eman Rrahmani tha se nuk mund të qëndrojë Komuna aq indiferente, sepse dy plane janë duke ecur njëkohësisht. Ju duhet me i dhënë njërsës përparësi se nuk jeni OJQ, jeni institucion. **Fadil Gashi** pyeti se nëse nuk bëhet Harta zonale, atëherë çka do të bëhet me lagjet tjera në Prishtinë!

Genc Bashota theksoi se Harta zonale do të bëhet, jemi duke punuar në këtë drejtim.

Fadil Gashi u shpreh se ne do ta votojmë Universitetin, lagjen "Dodona", e tash lagjet tjera, atëherë tregoni se çfarë interes i patët që i votuat këto, e lagjet tjera nuk i votuat.

Egzon Azemi pyeti se cili ishte kriteri për t'u zgjedhur "Dodona" e jo një lagje tjetër.

Genc Bashota theksoi se nuk janë vetëm këto të dyja, kemi pasur edhe më herët të tjera.

Ekzekutivi, në këtë rast Kryetari, ka të drejt që diçka që e sheh me prioritet me e sjellë para Kuvendit për me iniciuar një hartim të hollësishëm, një temë që atij i duket më prioritare se këto tjerat që ju po pyetni. Prioritetet i cakton Kryetari, unë si ekzekutiv e mbroj atë temë që është këtu. Ju lus që ta votoni, por e juaja është ta votoni apo mos ta votoni.

Eman Rrahmani theksoi se në bazë të deklaratave të drejtorit, Ardianit, ishte shumë i qartë se s'do të përfundohet hartimi zonal për shkak të legjislacionit, të paktën në periudhën e paraparë. Drejtori dhe ekzekutivi këtë rast, është duke u bërë shumë padrejtësi qytetarëve të Prishtinës, shumë lagjeve që nuk e kanë Planin e hollësishëm rregullues dhe kanë me mbetur edhe vite të tëra pa një plan të tillë.

Agim Kuleta, kryesues, tha se tash e kemi një situatë që të gjithë e dimë, ligjërisht, proceduralisht si është puna. Harta zonale do të duhej të ishte para se të dilnin dokumentet tjera prej saj, por situata është që nuk kemi harta zonale, për arsyet që u cekën, si do që të jetë, realiteti është ky.

Këtu i kemi dy çështje të shtruara, mendoj se janë bukur specifike dhe nuk mund të thjeshtohet krejtësisht problemi, me thënë kjo lagje është, kjo lagje nuk është, pse kjo, pse ajo!

Sa i përket lagjes "Dodona", të gjithë e dinë si është situata. Njerëzit kanë përjetuar trauma psikologjike dhe kanë pasur humbje materiale, sepse u është bërë një padrejtësi e madhe, kanë mbetur pa kulm mbi kokë dhe pa lokale. Pra, ky është një problem emocional dhe moral. Jo gjithmonë procedurat duhet qitura mbi gjithçka tjetër, mendoj se ka më tepër se procedurat diçka në momente të caktuara. Është rasti i Fakultetit Teknik, unë mendoj se si shoqëri jemi duke degraduar dhe ky degradim do të vazhdojë edhe më shumë nëse ne nuk e kthejmë vëmendjen pak nga shkenca si shoqëri. D.m.th. Kosova ka me pasur, nëse nuk ka tash, ka me u përballur me kuadro deficitare në këto fusha dhe orientimi ynë si shoqëri duhet me qenë atje. Mendoj se duhet kushtuar rëndësi të madhe dhe duhet trajtuar mirë dhe në mënyrë specifike, sepse janë dy situata që duhet trajtuar në mënyrë specifike. Në rast se nesër vjen një plan rregullues i një lagje tjetër, që nuk ka një specifikë që nuk dallon me lagjen tjetër, aty

duhet pasur qëndrim të prerë. Mendoj se këto dyja janë shumë specifike, prandaj ju ftoj që ta tejkalojmë këtë problem, t'i mbështesim këto, sepse ne e kemi interpretimin e Zyrës ligjore, për mua është valid interpretimi i Zyrës ligjore, pra është valid deri në vërtetimin nga Ministria. Nëse thotë Ministria jo e ka interpretuar gabim, e kthehen, e nëse thotë mirë e ka pasur, atëherë ecim tutje.

Eman Rahmani tha se problemi nuk është ashtu si po e paraqitni ju, qëndrimi ynë është që të japim zgjedhje për të gjithë, e jo vetëm për dy lagje, për dy plane të hollësishme, duke i respektuar procedurat, ne jemi që të zgjidhet problemi për të gjitha qytetarët e Prishtinës.

Egzon Azemi u shpreh se në fillim u pajtova me pyetjen e z. Agimit, kur pyeti se në çfarë afati kohor kryhet kjo çështje, për shkak pothuajse në të njëjtin afat ka qenë e parashikuar me përfunduar Harta zonale, kështu që do të jenë dy procedura të kota, pra më shumë kjo po bëhet për çështje politike. Ne po kërkojmë të kemi informacione më të detajuara, kështu që drejtori në këtë rast është dashur me ardhur me informacione më konkrete se çka ka ndodhur me Operën, a kanë biseduar me ta e tjera, kështu që mos të krijojmë konflikte në mes të Operës dhe Universitetit, të zgjidhet kjo punë një herë e mirë dhe t'ia lehtësojmë qasjen në atë Universitetit dhe studentëve, askush nuk është duke e bllokuar.

Kryesuesi konstatoi se më 8 vota për, u miratua Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm te Fakulteti Teknik, në lagjen " Bregu i Diellit "dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona".

Kryesuesi konstatoi se më 8 vota për, u miratua Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A 1, të lagjes "Dodona", dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimrregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës.

Osman Bllaca bëri të ditur se te kjo rregullore vetëm nenin 30 do të ketë ndryshime, ku nga 171 € bëhet 200 €, dhe në titull përmirësohet dhe bëhet Propozimrregullore.

Agim Gashi kërkoi që në titull të përmirësohet, sepse kjo nuk është Rregullore, por është Propozimrregullore.

Halim Halimi tha se neni 30 i Rregullores ndryshohet, si vijon: "Komuna mund të ndajë subvencione për shpenzimet e funeralit për anëtarët e ngushtë të personit të vdekur, deri në

shumën e paraparë prej 200 €'', nuk ka nevojë të jetë deri të hiqet, por të bëhet në shumën e paraparë prej 200 €.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, me dy propozimet për ndryshim, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës.

Egzon Azemi shprehu qëndrimin e Grupit, se këtë pikë drejtori i Pronës duhet rishikuar deri në seancën e radhës. Ne mendojmë se Morgu duhet t'i takojë Bashkësisë Islame (BI), mirëpo ndarja e tri parcelave është bërë me përgjegjësinë minimale të mundshme, për shkak se nëse shikohen parcelat si grafikojnë ato tri parcela, po jepen të panevojshme. Është një sipërfaqe jashtëzakonisht e madhe që po i lihet në dorë, në këtë rast BI-së, mirëpo problemi është se rruga kryesore e asaj lagjeje tanë e tutje, nëse ky votim ndodh në këtë format, do t'i takojë BI-së, mirëpo në të ardhmen nëse dikush dëshiron me ta bllokuar rrugën, ajo është pronë e tij dhe ka të drejt plotësisht me kërkuar pagesë prej Komunës, kështu që mundet shumë lehtë me u nda kjo parcelë në mënyrë më të mirë dhe Morgu i takon BI-së, kështu që me një angazhim të drejtorit ishte zgjidhur kjo punë.

Agim Gashi tha se Egzoni ka të drejt kur e shpjegon këtë, sepse i njëjtë problem pati ndodhur me Katedralen, është specifikë e njëjtë. Unë nuk pajtohem që parkingjet t'i takojnë BI-së. Nëse parcella del përtej sipërfaqes së objektit me oborr e prek rrugën, prandaj është mirë të bëhet një ndarje aty, një parcellim të sipërfaqes, që Vendimi i Kuvendit me qenë i përputhshëm me objektin dhe pjesët funksionale të objektit, por jo edhe parkingun, për shkak se nëse jepet parkingu, ata kanë me filluar me pagesë.

Dren Kukaj tha se nuk mund të them sigurt se mund t'i ndajmë, për shkak se problem gjithmonë kemi me parcelat, për shkak të këtyre kopjeve që qëndrojnë në Serbi, por ne mundemi me specifikuar sipërfaqen e saktë që jepet brenda këtyre parcelave me një skicë të veçantë. Këto do t'i kem parasysh dhe në asamble do të ua sjellë.

Agim Gashi bëri pyetje se kur të bëhet matja, a mund të thoni se në atë numër të parcelës jepet kaç sipërfaqe, kjo mjafton.

Egzon Azemi theksoi se në dokumentin që ne kemi sjellë ekzistojnë vijat ndarëse, kështu që nuk do të ishte problem edhe parcellimi.

Ardian Olluri theksoi se deri në mbledhje të Kuvendit gjeodetët mund t'i bëjnë skicat dhe me certifikuar në propozim se cilat pjesë janë të sakta nuk do të preken, e ndarjet bëhen pas Vendimit të Kuvendit.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë për ta dërguar në Kuvend, mirëpo në ndërkokë t'i sjellë materialet shtesë drejtori, Dreni, mundësish para mbledhjes së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë.

Dren Kukaj dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se i ka pasur në takim tri ndërmarrjet publike "Holtikultura", "Pastrimi" dhe "Trafiku Urban" lidhur me hapësirën që i kanë në mes të objekteve të tyre, sipas propozimeve që i kanë dhënë ata, dhe sipas nevojave që kanë pasur me i shfrytëzuar edhe janë bërë propozimet. Unë ua kam njojur kërkesat të tri ndërmarrjeve që kanë ardhur këtu si legjitime dhe asisoj i kam sjellë.

Agim Gashi tha se, nëse nuk gaboj, nuk jam i sigurt, në vitin 2010 ajo sipërfaqe e lirë që është livadh, i është dhënë ndërmarrjes "Hortikultura" për kultivimin e luleve, fidanishteve.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Hortikultura".

Eman Rrahmani shprehu mendimin se për dhënien në shfrytëzim të këtyre dy parcelave, së pari Drejtoria e Pronës duhet të sjellë në Kuvend dokument pronësor të përditësuar, sepse, siç shihet, në këto dokumente kërkesa dhe dokumenti pronësor janë të vitit 2015.

Kërkesa është e vitit 2015, po ashtu keni sjellë një certifikatë të pronës, ku titullari i pronës është Mbrojtja Popullore. Gjithashtu, në Vendim nuk është certifikuar sa është pjesa e sipërfaqes e cila do të jepet në shfrytëzim, por vetëm e keni shkruar prona e paluajtshme dhe një pjesë e parcelave kadastrale.

Osman Bllaca dha sqarime, duke cekur se kjo pikë ka qenë edhe një herë në Kuvend, mirëpo për shkak të kuorumi është ndërprerë kjo mbledhje dhe e kemi përsëritur, e njëjtë është.

Dren Kukaj tha se Emani po i kërkonit certifikatat azhur.

Eman Rrahmani tha dokument pronësor të përditësuar, sepse këtu po shihet se kërkesa dhe dokumenti pronësor janë të viti 2015.

Vala Peshku theksoi se kërkesa që parashtrohet është e vitit 2015.

Fatos Dibra u shpreh se kërkesa nuk ka lidhje, certifikatat duhet të bëhen të reja.

Ardian Olluri theksoi se Emani është duke i ngritur dy çështje, certifikatat që janë të vitit 2015, dhe besoj se ka të drejt, po ashtu paraqiti çështjen se pronari në certifikatë figuron Mbrojtja

Popullore. Mbrojtja Popullore është subjekt që nuk e di se ekziston. Sipas Ligjit, të gjitha pronat që nuk kanë pronarë e që gjinden në territor të Komunës, mund t'i regjistrojë si prona të Komunës.

Eman Rahmeni theksoi, atëherë certifikata duhet të sillen në pronësi të Komunës kur të sillen në Kuvend, për shkak se ne me një dokument të tillë nuk kemi të drejt për tjetërsime, me ditur kujt po ja japim.

Halim Halimi tha se të gjitha pronat që nuk janë komunale, në këtë rast ish-Mbrojtja Popullore, ato me ligj kanë kaluar si prona të Qeverisë.

Dren Kukaj theksoi se për këtë jam në ngjarje, është Vendimi i Dhurata Hoxhës, që i ka marrë disa prona të ish-institucioneve dhe janë kthyte prona të Republikës së Kosovës. Pronat e ish-Sekretariatit të Mbrojtjes Popullore që kanë qenë, për shembull janë kthyer dhe në regjistrat katastral shkruhet Republika e Kosovës, në saje të Vendimit të Dhurata Hoxhës sa ka qenë ministre e Drejtësisë.

Agim Gashi dha sqarime, duke cekur se kur kanë tentuar me ndërtuar strehimoren sipërfaqësore mbi Tokbahçe, e kemi bërë thurjen dhe pastrimin e objektit, ka ndërhyrë Qeveria në atë kohë dhe tek atëherë e kemi kupuar se të gjitha pronat të cilat kanë qenë pronë e ish-Ushtrisë dhe Mbrojtjes Popullore, tash kanë kaluar në pronësi të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të institucioneve analoge që sot ekzistojnë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Dren Kukaj theksoi se aktualisht është në hartim një ligj për prona publike, që është duke u trajtuar, nuk ka ndonjë Vendim apo ndonjë ligj që thotë se kjo pronë publike është e Qeverisë. Me sa jam unë i informuar, nuk ka, por unë po e shqyrtoj po ashtu, do ta kem parasysh që certifikatat me qenë të azhuruara dhe me u trajtua çështja e titullarit, të Mbrojtjes Popullore. **Halim Halimi** tha se në Vendim nuk ceket se sa sipërfaqe jepet, andaj kjo të ceket përmbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Hortikultura", me propozimet e paraqitura, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë.

Eman Rahmani theksoi se kërkesa e ndërmarrjes "Trafiku Urban" për Drejtorinë e Pronës nuk ka qenë për t'i dhënë parcelë në shfrytëzim, kërkesa ka qenë që Drejtoria e Pronës me dërguar ekipin e matjes gjeodezike për të shënuar pronën e Trafikut Urban, sepse dëshirojnë ta dinë pronën e vetë.

Dren Kukaj u shpreh se ne e kemi specifikuar, ne i kemi marrë tri NP, i kemi thirr në takim, ata kanë pasur problem, tri ndërmarrjet kishin problem njëra me tjetrën. Unë jam përpjekur për t'u bërë zgjidhje.

Egzon Azemi theksoi se kjo duhet të bëhet me dokumente, se shtet jemi, kjo çështje ka me mbetur edhe pas 4 viteve, edhe pas 8 viteve, pra duhet pasur dokumente e jo fjalë. Një kërkesë

mundesh me i thënë bëjeni prapë, ndryshoni pak, modifikone pak dhe kryhet kjo çështje, se është procedurë që ka me mbetur edhe pas kësaj qeverisje.

Ardian Olluri theksoi se prona është në emër të Komunës e jo të Trafikut Urban, këtë e dëshmojnë certifikatat e pronës që janë të bashkangjitura aty.

Egzon Azemi tha se nuk është problemi aty, problemi është se nuk ka kërkesë prej ndërmarrjes "Trafikut Urban".

Agim Gashi u shpreh se kur e lexojmë këtë, e shikojmë materialin, del se ne po ia ndajmë një sipërfaqe në shfrytëzim ndërmarrjes "Trafiku Urban", që nuk e ka pasur deri më tash, është identike me tjerat në aspektin teknik, shtrimit të përbajtjes së lëndës, dhe për atë arsyet shtrohet pyetja se a është fjala për sipërfaqe që e ka pasur deri tash në shfrytëzim. Është dashur me u sqaruar se është fjala për sipërfaqe që e kanë pasur në shfrytëzim, meqenëse është ndërtuar objekti i Zjarrfikësve aty në një kohë nuk është rregulluar çështja e parcelës dhe me këtë po e kufizojmë parcelën që do t'i takoj ndërmarrjes "Trafiku Urban".

Dren Kukaj tha se kjo kërkesë sigurisht ka me u paraqitur si ka me bë "Trafiku Urban" dhe ka me qenë pjesë e lëndës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë, me propozimet dhe vërejtjet, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Diskutim për Raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti vjetor i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Diskutim për Raportin vjetor të punës së KKSB-së.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti vjetor i punës së KKSB- së dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

Faqe 10 nga 10

**Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta**

